



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:000624

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05422842

**P.nr.1/2024**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Minir Hoti, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarit: A. K., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.7347/2023 të datës:28.12.2023, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 06.03.2024, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Besart Mustafa, dhe të akuzuarit në të njëjtin ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 07.03.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari,

**A. K.** nga i ati I. dhe nëna A. e vajzërisë M., i lindur më dt....., me vendbanim në Podujevë, rruga “D. B.”, me numër personal të identifikimit:....., ka të kryer shkollën e mesme, profesioni kuzhinier, i gjendjes së mesme ekonomike-sociale, i pa martuar, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### Sepse:

Me datë 05.12.2023 rreth orës 16:10 minuta, në rrugën “N. G.” në Podujevë, i pandehuri me qëllim të frikësimit, ka kanosur seriozisht me fjalë se do ti shkaktojë ndonjë të keqe të dëmtuarit T. K., në atë mënyrë që pa ndonjë arsye i pandehuri fillimisht del nga vetura dhe e kap për rroba të dëmtuarin dhe derisa e mbanë i drejtohet me fjalët kërcënuese se “do ti nxjerrri zorrët ku të takojë përsëri”, me të cilat veprime të dëmtuarit i kishte shkaktuar ankth, frikë dhe pasiguri për jetën.

- me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 181 të KPRK-së si dhe në bazë të neneve 242, 364, 365, 368, 369, 452, 462 të KPPRK-së, e:

## **G J Y K O N**

- I. Me dënim me gjobë në shumën 150.00€ (njëqind e pesëdhjetë/euro), i cili dënim do të ekzekutohet pas kalimit të afatit prej (pesëmbëdhjetë) 15 ditë, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.
- II. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e lartcekur, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20.00€ (njëzet euro), të papaguara të gjobës do t'i llogaritet 1(një) ditë burgim.
  - I. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.
- III. I dëmtuari: T. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP/II.nr.7347/2023 të datës:28.12.2023, kundër të akuzuarit: A. K., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datë 06.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Besart Mustafa nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, si dhe i akuzuari, ndërsa nuk ka prezantuar i dëmtuari, sipas informatës së Stacionit Policor në Podujevë, T. K., nuk është takuar në adresën e tij, familjarët e tij pohojnë se i njëjti gjendet në Kroaci.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se: Për ato fjale që i kam thënë i pranoj, ky rast nuk do të përsëritet më asnjëherë, lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim sa më të lehtë, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe gjykatës, e tëra ka qenë e rastit me Taulantin jemi rregulluar familjarisht, nuk kam pasur asnjë qëllim që ta lëndoj vetëm që të ja tërheqë vrenjtje për mos të folur me diçka për mua, jam mbajtës i familjes vitin e kaluar më ka vdekur baba, kam filluar te punoj si kuzhinier.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në

faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, nga se pranimi i fajësisë nga mbështetje në dispozitat ligjore të KPPRK-së, i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, të pandehurin të shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pendimin dhe kërkim faljen për veprën e kryer penale si dhe premtimin e të pandehurit se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burg është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal  
P.nr.1/2024 me dt.07.03.2024**

**G j y q t a r i**

---

Minir Hoti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.